


RTK e publikut

Raporti vjetor i aktiviteteve 2023
i dorëzohet Kuvendit të Kosovës nga Bordi i Radiotelevizionit të Kosovës

www.rtklive.com

RTK



NË KËTË RAPORT:

1. RRETH RTK-së
2. DEKLARATA E KRYETARIT TË BORDIT
3. PASQYRA E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM
4. INVESTIMET KAPITALE
5. SKEMA PROGRAMORE
6. ÇFARË TRANSMETUAM NË RTK1/3/4?
7. RTK 2
8. RADIO KOSOVA
9. INOVACIONI DHE IT
10. RAPORTI FINANCIAR
11. STAFI - BURIMET NJERËZORE
12. PROJEKTET- MARRËDHËNIET NDËRKOM BËTARE
13. DEPARTAMENTI PËR ZHVILLIM DHE STRATEGJI
14. PËRFUNDIMI
15. SHTOJCAT

RTK në shifra

Prodhimi

Këtë vit është rritur prodhimi në të gjitha platformat e RTK-së

3,750 orë
materiale premierë në RTK1

88.67%
e programit, prodhim i RTK-së

78 emisione
javore televizive (RTK1 dhe RTK2)

25,956
lajme të publikuara në portal

7,200
poste në facebook

13 mijë video
204 Live stream
45 video shorts
të publikuara në youtube

46,696 video
materiale të reja të arkivuara në sistemin e brendshëm

966 orë
ose 505 kaseta të digjitalizuara nga arkiva në TV

1,300 orë
apo 4,270 shirita të digjitalizuara me audio materiale në Radio

Publiku

Dy matje të shikueshmërisë tregojnë se RTK është ndër mediet më ndjekura në vend

1 në 3
qytetarë e shikon së paku një herë në ditë RTK-në, 18% e të tjerëve disa herë në ditë (burimi UBO)

Programi i mëngjesit
i RTK1 është më i shikuari në vend me audiencë mesatare prej 19.51% (Burimi Mediametri, maj **2023)**

67.3%
ndjek Lajmet Qendrore në RTK

13 milionë
vizita në rtklive.com

1 milion
apo 528 % rritje nëshikime në Instagram

2.2 milionë
shikime në Tik Tok

136.9 milionë
minuta të shikuara në facebook

105.8 milionë
shikime në yoututube (+46.3K abonues të rinj)

Ne

Gjatë vitit 2023 RTK ka reduktuar stafin dhe shpenzimet komunale

742 persona
(staf i rregullt dhe bashkepunetorë) krahasuar me1039 sa ishin më 2021

1000%
reduktim të shpenzimeve në mbeturina

300%
rritje të investimeve kapitale krahasuar me 2022

1,7 milionë Euro
më pak shpenzime në paga krahasuar me 2021
(Nga 9,71 milionë në 2021 në 8,01 milionë)

650,111 Euro
të hyra Cash nga Marketingu

114,000 Euro
të përfituara nga projektet e jashtme

RRETH RTK-së



Transmetuesi Publik i Kosovës ofron program për publikun në të gjitha gjuhët e folura në Kosovë përmes katër kanaleve televizive:

- RTK 1, RTK 2, RTK 3 dhe RTK 4-Art;
- dy kanaleve të RTK-Radio: Radio Kosova 1 dhe Radio Kosova2 ;
- përmes portalit rtklive.com dhe
- rrjeteve sociale

Kanali televiziv RTK TV1 dhe RTK TV2 janë të obliguara të ndajnë 15% të skemës së tyre programore për gjuhët e komuniteteve të tjera të Kosovës. RTK ofron edhe programe satelitore për kosovarët që jetojnë jashtë Kosovës.

Misioni ynë mbetet që të jemi pjesë e çdo familjeje, duke ofruar programe që informojnë, edukojnë dhe argëtojnë.


Organet drejtuese të RTK-së janë Bordi i RTK-së dhe Drejtori i Përgjithshëm.


Gjatë vitit 2023, Bordi ka funksionuar kryesisht me 10 anëtarë dhe është udhëhequr nga Besnik Boletini, nënkryetarja Arta Berisha dhe anëtarët:Fatime Lumi-Qehaja, Safet Kabashaj, Albulena Mehmeti, Driton Hetemi, Birol Urcan, Dardan Beqiri dhe Radojica Mrdjinac ndërkaq Drejtori i Përgjithshëm është Shkumbin Ahmetxhekaj.

Pos tyre, RTK ka funksionale edhe Komitetin e Auditimit të Brendshëm dhe Grupin Këshillues të Publikut, të cilët janë nën ombrellën e Bordit të RTK-së.

Që nga viti 2015, financimi i RTK-së bëhet përmes subvencionit dhe jo përmes dispozitës ligjore që e përcakton financimin me 0.7% të të hyrave nga buxheti.

Ky lloj i financimit përmes subvencionit e vështirëson zhvillimin teknologjik dhe programor me ritme më të shpejta.





RTK e ka përmbyllur vitin 2023 me 722 punëtorë të rregullt/aktivë dhe me rreth 1.6 milion euro më pak shpenzime në paga, krahasuar me vitin 2021. Këto janë shifrat më të ulëta në një dekadë.



Besnik Boletini
Kryetar i Bordit të RTK-së

Deklarata e kryetarit të Bordit

Viti 2023 për Radiotelevizionin e Kosovës ishte mjaft dinamik, por edhe sfidues. Bordi i RTK-së u angazhua duke luajtur rolin që e ka për të udhëhequr dhe drejtuar RTK-në, përkatësisht duke marrë vendime dhe veprime të shumta dhe të ndryshme, e të cilat quan drejtë përmirësimit të situatës në përgjithësi.

Gjatë vitit 2023 Bordi ka mbajtur 62 mbledhje duke përfshirë edhe ato online, dhe ka nxjerrë 86 vendime/rekomandime.

Edhe gjatë këtij viti ka pasur angazhim lidhur me çështjen e pronës dhe modeleve të financimit të RTK-së, e të cilat janë determinuese për zhvillimin dhe funksionimin e qëndrueshëm të transmetuesit publik. Për këtë qëllim Bordi ka miratuar dhe dërguar në Kuvendin e Republikës së Kosovës dy raporte të detajuara mbi modelet e financimit të transmetuesit publik dhe opsionet për zgjidhjen e çështjes së pronës. Prona dhe financimi mbesin dy sfidat kryesore të RTK-së gjatë funksionimit të përditshëm. Objektet aktuale nuk ofrojnë kushtet minimale për punë dhe rrjedhimisht paraqiten pengesa të përditshme në realizimin e punës. Definimi i pronës së RTK-së është tejet i domosdoshëm dhe emergjent. Gjatë punës së këtij njëvjeçari Bordi është kujdesur që shpenzimet të mos tejkalojnë të hyrat. Rrjedhimisht ky është viti i dytë i bordit aktual ku RTK operon pa hyrë në borxhe të reja, ndërkaq në anën tjetër një pjesë borxhit të trashëguar ndër vite është shlyer. Edhe këtë vit në total RTK kishte 2.3 milion euro më pak sesa në vitet paraprake. Bordi gjithashtu ka rekomanduar uljen e shpenzimeve në disa kategori dhe ka racionalizuar shpenzimet në përgjithësi. Mjetet e kursyera janë rialokuar në investime kapitale, dhe investime të tjera, veçanërisht në fushën e sportit dhe IT-së. Sigurimi i buxhetit për pagesën e këstit të parë për transmetimin e Ligave të Evropës ka qenë një sfidë e zgjidhur me kujdes. Investimet tjera kanë përfshirë blerjen dhe instalimin e dy transmetuesve të rinj në Golesh për Radio Kosova 1 dhe Radio Kosova 2 me qëllim të fuqizimit të frekuencave në këto dy kanale. Transmetuesit paraprak kishin më shumë se dy dekada që ishin instaluar dhe kishin humbur fuqinë e sinjalit në vitet e fundit. Bordi është në dijeni që edhe shumë pajisje tjera tashmë janë vjetërsuar dhe kanë më shumë se dy dekada pa ndërruar. Investimi në këtë aspekt është i domosdoshëm. Për këtë qëllim kemi bërë kërkesë në Kuvendin e Kosovës për buxhet shtesë. Në kuadër të krijimit të kushteve më të mira dhe të pranisë sa më të madhe në terren, në vitin 2023 filloi puna në zyrën rajonale të RTK-së në Mitrovicë. Tashmë një pjesë e stafit punon nga ajo zyrë dhe ai rajon mbulohet në kohë reale dhe RTK ka prani të vazhdueshme. Veçanërisht për çdo zhvillim që ndodh në veri të vendit, ekipet e RTK-së janë ndër të parat që dalin në vendin e ngjarjes dhe mbulojnë zhvillimet.

Bordi i RTK-së përmes mekanizmave të tij kontrollues; Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB), Komiteti i Auditimit (KA) dhe Grupi Këshillues i publikut (GKP) ka arritur ta rritë nivelin e performances dhe kontrollin e brendshëm të proceseve të punës në Transmetuesin Publik. Njësia e Auditimit të Brendshëm gjatë vitit 2023 ka realizuar nëntë auditime, ndërkaq ka dhënë 36 rekomandime për përmirësimin dhe fuqizimin e kontrolleve të brendshme dhe përmbushjen e objektivave të përgjithshme. Komiteti i Auditimit gjatë vitit 2023 ka mbajtur dymbëdhjetë takime, duke filluar nga shqyrtimi i raporteve të ZKA, raporteve finale të NjAB të RTK-së, intervistat me zyrtarët përgjegjës në RTK dhe dokumenteve tjera relevante. Ne takime janë diskutuar 23 pikat kryesore, respektivisht kanë dalë me 66 konkluza/rekomandime të cilat pas çdo takimi u janë dërguar Bordit të RTK-së për të vazhduar më pas me raportin final për vitin 2023. Grupi Këshillues i Publikut në anën tjetër ka mbajtur dymbëdhjetë takime të rregullta dhe ka trajtuar të gjitha adresimet që janë bërë nga qytetarët lidhur me përmbajtjen programore të RTK-së. Pas analizimit dhe ato janë përcjellë në bord për trajtim.

Gjatë vitit 2023, RTK për herë të parë ka organizuar festivalin e këngës, një organizim që u karakterizua me shumë sfida edhe për Bordin e RTK-së, duke filluar me rregullimin e procedurave për realizimin e festivalit si krijimi legjislacionin sekondar, e cila paraqet bazën e themelimit, organizmit dhe funksionimit të festivalit, analizimi i ndarjes së linjave buxhetore etj. Gjetja e lokacionit dhe investimi në atë vend për ta adaptuar për sallë të festivalit ishte sfidë e vështirë por e realizuar me sukses. Festivali i Këngës ishte ngjarja më e madhe kulturore e organizuar në Kosovë. Përkundër që në menaxhim ka pasur një trend pozitiv të progresit në shumë fusha, zbatimi i skemës programore ka pasur ngecje. Disiplina e realizimit të emisioneve nuk ka qenë në nivelin e duhur. Në anën tjetër edhe nisja e disa emisioneve të reja të miratuara nga bordi, nuk kanë filluar të transmetohen sipas dinamikës së paraparë. Ngecje ka pasur edhe në zbatimin e rregullores për konflikt interesi. Departamenti i marketingut nuk ka qenë efikas aq sa është pritur dhe aq sa duhet.

Bordi miratoi nisjen e reformës në RTK, duke e konsideruar një proces të nevojshëm dhe të domosdoshëm. Drafti i propozuar nga drejtori i përgjithshëm nuk është aprovuar në parim, pasi që duhet bërë disa ndryshime tjera konceptuale dhe organizative. Bordi është i angazhuar në këtë proces me bindjen që RTK përmes reformës do të dalë më funksionale dhe më e organizuar. Bordi ka pasur një qasje proaktive në mbikëqyrjen e zbatimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Plani i zbatimit të rekomandimeve ka qenë i pranishëm në çdo mbledhje të bordit. Me qëllim të vendosjes së ligjshmërisë dhe funksionimit sa më të mirë të RTK-së, Bordi ka miratuar disa rregullore të reja, si dhe ka plotësuar dhe ndryshuar disa nga rregulloret ekzistuese njëkohësisht duke i harmonizuar me legjislacionin primar. Me qëllim të përmbushjes së misionit, Bordi i RTK-së ka mbikëqyrur në vazhdimësi skemën programore dhe është kujdesur që të gjitha raportimet të jenë në përputhje me standardet profesionale dhe etikën gazetareske. Aty ku ka pasur ndonjë devijim ka marrë masa të menjëhershme, siç ishte suspendimi i drejtorit të RTK2. Transparenca e instaluar qysh në marrje të mandatit ka vazhduar. Mbledhjet e bordit janë të hapura. Në anën tjetër të gjitha konkurset kanë vazhduar të jenë të hapura për monitorues të brendshëm apo të jashtëm. Në këtë mënyrë është rritur përgjegjësia, llogaridhënia dhe meritokracia në transmetuesin publik.



Ministri i MKRS-së Hajrullah Çeku dhe kryetari i Bordit të RTK-së Besnik Boletini nënshkruan Memorandumin e Bashkëpunimit me 9 shkurt 2023.

4. Pasqyra e Drejtorit të Përgjithshëm



Shkumbin Ahmetxhekaj
Drejtor i Përgjithshëm i RTK-së

Vitin 2023 e kishim përcaktuar si vit të transformimit të RTK-së nën moton "Më shumë prodhim, më pak burokraci". Mbi këtë mision punuam me plot pasion në strukturën e re organizative, por edhe në zbatimin e shumë projekteve që synim kishin fuqizimin e Transmetuesit Publik. Bindja jonë është se në masë të konsiderueshme ia dolëm që ta transformojmë Transmetuesin Publik në të gjitha dimensionet: programor, financiar dhe teknologjik.`

RTK ekziston që të informojë, të edukojë dhe të argëtojë audiencën anekënd Kosovës, në të gjitha gjuhët dhe për të gjitha moshat. Ky mision mbetet bazë e secilës strategji zhvillimore dhe plani të punës për strukturat drejtuese të Transmetuesit Publik.

Objektivat e punës të njësive dhe departamenteve të RTK-së ndërtohen pikërisht mbi parimin që të jenë në shërbim të publikut.

Gjatë vitit 2023 jemi siguruar që RTK-ja të jetë relevante, medium me ndikim dhe pos tjerash jemi angazhuar në ndërtimin e një strategjie afatgjate që synon dominimin në tregun medial, në kohën e epokës digjitale.

Raporti prezanton ndryshimin substancial të Transmetuesit Publik, në një kohë kur konkurrenca është shtuar ndërkaq fondet janë zvogëluar.

Ky raport dëshmon angazhimin e palëkundur në qëllimin për transformimin e RTK-së, evoluimin e kulturës së punës, llogaridhënien dhe transparencën si dhe mbi të gjitha pasurimin e programit në të gjitha platformat transmetuese.

Mungesa e financimit të qëndrueshëm dhe bazuar në ligj pamundësoj zhvillim më të hovshëm teknologjik dhe programor, por të dhënat dëshmojnë se edhe më këto pengesa, RTK ka prodhuar më shumë dhe ka qenë më afër publikut.

Shembull i këtij konstatimi është se vetëm në kanalin e parë të TV-së, kemi rritje në 8.4% të programeve kulturore dhe edukative dhe se në total skema programore e RTK1 ka 64 emisione që prodhohen nga vet stafi i brendshëm.

Pos tjerash, ne vazhduam të zgjerohemi. Në mars të këtij viti hapëm zyrën rajonale në Mitrovicë me ndihmën e partnerëve tanë nga Agjencia Japoneze për Zhvillim Ndërkombëtar.

Programi ynë ishte i pasur dhe me shumë risi. Këtë vit bëmë histori duke nisur Festivalin e Këngës në RTK, një ngjarje kombëtare përmes së cilës synojmë ta përfaqësojmë Kosovën në Festivalin Evropian të Këngës.

Po ashtu, i dhuruam publikut një koncert tematik për 15-vjetorin e pavarësisë "Rrno për me tregue" me rrëfime autentike e këngë memoriale që janë vulë e historisë sonë të re.

Kontraktuam serialin më të lirë në dekada dhe shtuam përqindjen e programeve arsimore dhe kulturore. Kjo dëshmohet edhe me nisjen e emisionit të përditshëm informativ kulturor @Rtkulturë.

Mbajtëm premtimin për sinjal më të pastër dhe



Adrian Krasta, Edona Reshitaj dhe Besim Dina duke udhehequr natën finale të festivalit

me mbulueshmëri më të madhe, duke investuar në sistemin e antenave për frekuencat e kanaleve të Radio Kosovës, investim ky i munguar për më se dy dekada.

Duke trefishuar investimet kapitale, ne arritëm që të blejmë kamera robotike, duke ndjekur hapin e

teknologjisë së fundit. E natyrisht, brenda kapaciteteve përmirësuam edhe kushtet e punës.

Përmes thirrjeve publike arritëm që të kontraktojmë kompani për rregullimin e skenografive të reja në RTK 1, RTK 2 dhe për studion e Radio Kosovës nga ku për herë të parë ka nisur transmetimi i podcasteve.

Misioni ynë primar mbetet paanshmëria. Zhvillimet në veri të vendit gjatë muajve maj dhe shtator ishin një rikujtim se sa i rëndësishëm është raportimi profesional dhe sa jetike është ekzistenca e transmetuesit publik. Zyra jonë në Mitrovicë ka shërbyer si bazë edhe për mediat e tjera private.



Gjatë këtij viti, dëshmuam rikthimin tonë të fuqishëm duke siguruar të drejtat e pakos ekskluzive A për Ligën e Kampionëve, Evropa Ligën dhe Konferencë Ligën për sezonet 2024-2027, në gjuhën shqipe dhe serbe.

Raportimi ynë profesional për të gjitha komunitetet është vlerë e shtuar për vetë Kosovën.

Në këtë kontekst gjatë vitit 2023 jemi angazhuar për rritjen e prezencës online edhe për komunitetet joshumicë, duke mundësuar që RTK-ja të jetë dritare e informimit për të gjithë.

Gazetarët e RTK-së janë shpërblyer me çmime vendore e ndërkombëtare.

Në një rast, një gazetari të RTK-së i është sulmuar prona, por që rasti mori epilog shpejt dhe autori u përball me drejtësinë.

Në zhvillimin tonë të gjithëmbarshëm zë vend edhe prania jonë e shtuar në mediat online, ku shifrat dëshmojnë për rritje të ndjekësve në rrjetet sociale dhe për shumëfishim të postimeve të materialeve tona. Kjo na ka mundësuar që të arrijmë në pikën ku mundemi të gjenerojmë më shumë të hyra nga rrjetet sociale.

Jemi angazhuar që të zbatojmë në maksimum kërkesën e vazhdueshme të Bordit për barazi gjinore në emisionet e RTK-së, gjë e cila ka progres konstant.

Reforma në Transmetuesin Publik, e nisur më 2022 ka marrë formë dhe ka qenë në agjendë gjatë tërë vitit 2023. Grupet profesionale të RTK-së kanë prezantuar një draft të rregulloreve dhe organogramin e ri, që pritet të diskutohet më në detaje gjatë këtij viti me Bordin e RTK-së, me ç'rast do të adresohen dhe do të merren parasysh vërejtjet në këtë model të prezantuar.

Po ashtu, është punuar me përkushtim në Strategjinë Zhvillimore 2024-2027, ku ndër të tjera parashikohet që RTK-ja të hapë kanal online me dedikim për gjeneratën Z, nga 13-29 vjeç. Ekipet profesionale të RTK-së do ta adresojnë tutje këtë ide të rëndësishme zhvillimore, gjë për të cilën do të kemi nevojë për ndihmë nga themeluesi.

Kur flasim për shkallën e angazhimit për transformimin e RTK-së, jo vetëm strukturor, vlen të përmenden edhe dy raportet e dërguara në Kuvend për Modelet e Financimit dhe Pronën, miratimi i të cilave nga ana e Kuvendit do të kishte ndikim të jashtëzakonshëm për zhvillimin dhe qëndrueshmërinë e Transmetuesit Publik.

Duket vështirë e besueshme, por është fakt që RTK-ja nuk ka pronë që nga themelimi me 1999 e as fi-



Koncerti "Rrno për me tregue", 17 shkurt 2023

nancim të qëndrueshëm që nga viti 2010.
Prandaj, ne besojmë se planet e dërguara në Kuvend u japin zgjidhje të rëndësishme këtyre dy çështjeve ekzistenciale, ku ndër të tjera kemi kërkuar që financimi të bëhet nga parapagimi. Duke e propozuar një model të tillë, ne dëshmojmë përkushtimin tonë që të shtojmë cilësinë, shumëllojshmërinë dhe adaptimin e asaj çfarë ofron epoka digjitale.
Gjatë vitit 2023, kemi nisur digjitalizimin e arkivit në TV dhe Radio, proces ky që ka vlerë historike për vendin.
Transparenca dhe llogaridhënia janë bazë e secilit veprim administrativ dhe financiar. Kjo dëshmohet edhe me raportet e auditimit.
Për të arritur zhvillimin e dëshirueshëm dhe për të zbatuar planet e njësive, RTK ka nevojë urgjente për rishikim të buxhetit, në mënyrë që vitin 2024 ta shndërrojë në vit të transformimit të madh teknologjik e programor.



Instalimi I dy transmetuesve të rinj në Golesh për Radio Kosova 1 dhe Radio Kosova 2

Investimet kryesore kapitale

Krahasuar me 2022-n, në vitin 2023 janë trefishuar investimet kapitale të cilat kanë impakt të drejtpërdrejtë në cilësinë programore, por edhe në kushtet e punës së punëtorëve.
Pas më shumë se dy dekadash kanë nisur investimet në fuqizimin e frekuencave të dy kanaleve të Radio Kosovës, gjë të cilën e kemi premtuar si prioritet edhe gjatë debatit me publikun në maj të këtij viti.
Proceduarat për blerjen e dy transmetuesve për pikën qendrore në Golesh dhe sistemit të antenave në Zatriq, që mbulon rajonin e Dukagjinit, kanë nisur në tremujorin e fundit të këtij viti.



Kamerat robotike

Falë një donacioni të EBU-së që janë dakorduar për rialokim të mjeteve të një projekti në vlerë prej 16 mijë eurosh, janë blerë 28 kompjuterë dhe 4 tabletë. Pas më shumë se një dekadë pune me pajisje të vjetërsuara, tani kolegët serb RTK 2 dhe RTK Radio punojnë me pajisje të reja.


Janë blerë kamerat robotike për studion e lajmeve në RTK 1, gjë e cila pos që e vendos RTK-në në trend me zhvillimet e fundit teknologjike, po ashtu ka ndikim edhe në racionalizimin e stafit.
Janë blerë kamera të reja të terrenit, njësi të reja të montazhës dhe është funksionalizuar Post Produk sioni.

Po ashtu, falë një donacioni nga UNMIK-u është bërë rregullimi i hyrjes në objektin e RTK-TV dhe është ndërtuar shtegu për personat me aftësi të kufizuara. Përmes një thirrjeje publike është përzgjedhur një kompani për montimin e skenografive të reja në RTK 1, RTK 2 dhe në Radio Kosovë. Pos këtyre investimeve, janë realizuar edhe shumë projekte më të vogla (të shpalosura te raportet e njësive veç e veç) por me impakt të madh programor.

ÇFARË TRANSMETUAM MË 2023?

Skema programore e RTK 1 ndër vite ka rritur ndjeshëm prodhimin e emisioneve. Mungesa e buxhetit adekuat ka pamundësuar zbatimin e plotë të ligjit për RTK-në, veçmas për producentët dhe produksionet e pavarura. Gjatë vitit 2023 janë kontraktuar tri projekte nga producentë/produksione të pavarura, ku dy prej tyre përmes kompensimit me marketing. Por, hapësira programore me program të jashtëm nuk arrin 15 % që kërkohet me ligj.


Redaksia informative që e përbëjnë të gjitha edicionet e lajmeve, në vitin 2021 është përfshirë me 21.5% të skemës programore, kjo përqindje është rritur në vitet 2022 dhe 2023, përkatësisht 22.6% për vitin 2022 dhe 27.4% për vitin 2023, për shkak të zhvillimeve politike dhe të sigurisë. Programet e përbashkëta në vitin 2021 kishin 24.3% të përfshirë brenda skemës programore, në vitin 2022 me 21.3% dhe gjatë vitit 2023 me 25.2%. Prioritet mbetet rritja e stafit në redaksinë hulumtuese.



***Përqindja në grafikon paraqet orët e transmetimit gjatë vitit 2023 në RTK1.**

***Rritja tek programi informativ nuk nënkupton emsione të reja por Speciale për shkak të zhvillimeve në veri dhe rreth dialogut Kosovë-Serbi.**

Numri i emisioneve përgjatë viteve - RTK1



Festivali i Këngës në RTK

Festivali i parë i këngës në RTK ka filluar aktivitetet e tij në muajin shkurt të vitit 2022.
Realizimi i këtij projekti është mundësuar falë bashkëpunimit në mes të RTK-së dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, e konkretizuar përmes memorandumit të mirëkuptimit.

Revitalizimi i sallës për Festivalin e Këngës së RTK-së





La Fazani - "Oj Kosovë"
Kënga fituese e Festivalit të RTK-së

Në projektin e Festivalit të Këngës, kontribut ka dhënë edhe Komuna e Prishtinës përmes investimit në rivitalizimin e sallës së djegur të Pallatit të Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë dhe shndërrimin e ambientit si një set xhirimi përkatësisht shtrimit te sallës me lëndë drusore, sigurimi dhe vendosja e karrigeve, vendosja e perdeve të zeza rrethuese, gjetja dhe montimi i tribunës VIP etj.

Revitalizimi i sallës për Festivalin e Këngës së RTK-së

Gjatë tri netëve të Festivalit 26-28.10.2023 janë angazhuar rreth 100 bashkëpunëtorë profesionalë të profileve të ndryshme, shumica prej tyre emra të njohur të fushës së artit dhe kulturës.

Rreth 5000 qytetarë të Republikës së Kosovës kanë pasur mundësinë të ndjekin Festivalin nga Salla e djegur ndërkaq përmes platformave televizive të RTK-së, RTSH-së dhe RTM në të cilat netët e Festivalit janë transmetuar live edhe qindra mijëra qytetarë të tjerë.

Emra të njohur të fushës kanë komentuar netët e Festivalit në edicionin special të Post-Festivalit të realizuar në përmbylljen e natës së parë dhe të dytë, ndërkaq edicioni maratonik në kohëzgjatje prej 4 orëve ka zbuluar prapaskenat dhe aktorët e përfshirë në realizimin e Festivalit. Raporti i plotë.



Dafina Zeqiri performon si e ftuar në natën e parë të festivait

Informacioni

Ky vit raportues ishte mjaft sfidues. Zhvillimet e dhunshme në veri duke përfshirë edhe sulmin terrorist të shtatorit në fshatin Banjskë, u raportuan në kohë reale, në të gjitha gjuhët dhe në të gjitha platformat duke dëshmuar profesionalizëm të lartë dhe paanshmëri nga stafi i RTK-së pa dallim.

Ndërsa më 16 qershor 2023, në Leposaviq, përderisa ishin duke raportuar janë sulmuar fizikisht nga grupet kriminale serbe gazetarja Venera Xhoxhaj



dhe kameramani Bardh Bekteshi.

Pjesë e edicioneve të lajmeve, magazinave ditore dhe emisioneve debatuese ishin edhe zhvillimet e tjera të rëndësishme në vend dhe botë.

Përmes edicioneve speciale dhe lidhjeve të drejtpërdrejta me gazetarë është trajtuar -

Marrëveshja Kosovë-Serbi me 11 nene, e bërë publike më 27 shkurt, e cila kërkonte nga të dyja vendet që t'i pranojnë dokumentet dhe simbolet e njëratjetrës, përfshirë: pasaportat, diplomat dhe targat etj.

Përveç trajtimit dhe pasqyrimit në edicione të lajmeve, RTK ka sjellë program special me mysafir të ftuar e raportime direkte nga vendi i ngjarjes për takimin Borrel-Kurti-Vuçiq që zhvillohej në Ohër të Maqedonisë së Veriut, ku pas disa muajsh tensione, Kosova dhe Serbia pajtohen për zbatimin e Marrëveshjes për normalizimin e marrëdhënieve mes tyre, të mbështetur nga BE-ja.

Më 23 prill u mbuluan zgjedhjet e parakohshme lokale në 4 komunat me shumicë serbe në
veri të Kosovës - Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq.

Eskalimi i situatës në 4 komunat në veri më 26 maj, kur kryetarët e rinj morën pozitat e tyre dhe u vendosen në objektet komunale u trajtua në këndvështrimin e të gjitha pozicioneve. Sulmet ndaj gazetarëve, Policisë dhe KFOR-it, i kemi sjellë në kohë reale me transmetime të drejtpërdrejta nga gazetarët dhe ekipet teknike të RTK-së.

Në edicionet e RTK-së janë trajtuar po ashtu tema nga siguria, gjykimi në Hagë, ekonomia, arsimi, kultura dhe sporti. Sa i përket gjykimit ndaj ish-krerëve të UÇK-së në Hagë, në fillim të këtij procesi ekipi i RTK-së ka raportuar drejtpërdrejt nga atje, më pas gazetarët që ishin caktuar në ekipin për të përcjellë gjykimin në Hagë, kanë realizuar kronika dhe intervista për këtë proces.

Nga fusha e ekonomisë janë trajtuar tema sa u përket tarifave të energjisë, subvencionimit të energjisë, ekonomisë joformale, inflacioni, marrëveshjet ekonomike me vende të caktuara, ndarjet buxhetore në komuna dhe investimet ekonomike në çështje të caktuara.

Mungesa e teksteve shkollore, analfabetizmi, shkollat me shumë e më pak nxënëse janë tema që janë trajtuar disa herë në edicionet e lajmeve por edhe në emisionin "Kriter". Nga kultura rëndësi i është dhënë diversitetit dhe trashëgimisë kulturore të vendit, siç është zbulimi në parkun arkeologjik "Ulpiana", të mbishkrimit të Perandorit Justinian, 'Qyteti i Dardanisë".

Nga data 4 gusht deri më 12 gusht është mbuluar me lidhje të drejtpërdrejta festivali "Dokufest" .

Emisioni "Porta" në RTK1 ka trajtuar dhjetëra tema për familjen, ndërkaq "Sense' ka sjellë intervista interesante për tema të ndryshme sociale e filozofike.

Edhe gjatë këtij viti janë hulumtuar tema të shumta në kuadër të emisionit 'Udhëve", ndërkaq në emisionin "Voyage" janë trajtuar ngjarje historike, në kontekst të zhvillimeve aktuale.

Sporti

RTK, edhe gjatë vitit 2023, shërbeu si promotori më i madh i sportit dhe sportistëve të vendit. Krahas kësaj, nuk u lanë anash as një mori ngjarjesh ndërkombëtare. Qindra orë të transmetimeve të edicioneve ditore të sportit "Sport PLUS" dhe emisionit sportive më me traditë në Kosovë "AS".
Transmetuesi Publik, në kuadër të përmbushjes së misionit për mbulimin e aktiviteteve ndërkombëtare, ku paraqiten sportistët kosovarë, po ashtu transmetoi ekskluzivisht edhe EOC Lojërat Evropiane që u mbajtën në Krakov të Polonisë.



Pa dyshim, lajmi kryesor që e veçoi 2023-n në sportin kosovar ishte edhe marrja e së drejtës për organizimin e Lojërave Mesdhetare "Prishtina 2030". Në asamblenë e përgjithshme të Komitetit Ndërkombëtar të Lojërave Mesdhetare (ICMG), RTK ishte i vetmi transmetues nga Kosova dhe mbarë bota, të cilit iu mundësua qasja në punimet e kësaj asambleje dhe transmetimi i drejtpërdrejtë i tërë momentit historik. RTK-ja, gjatë procesit të aplikimit, kishte nënshkruarar një zotim për transmetimin e këtyre lojërave.

Për adhuruesit e basketbollit, gjatë 2023-s, RTK solli ekskluzivisht ndeshjet e KB Peja në garat e BIBL Ligës Ballkanike, duke shënuar rikthimin e transmetimeve nga palestra "Karagaçi" pas 18 vjetësh.
Po ashtu RTK siguroi të drejtën e transmetimeve të ndeshjeve të KB Sigal Prishtina në ENBL League. Në sportet vendore, RTK ishte bartëse e së drejtës ekskluzive edhe nga Superliga e Volejbollit për djemtë dhe vajzat.
Në ngjarjet ndërkombëtare, u transmetua ekskluzivisht UEFA Euro U21, FIFA Kupa e Botës U20, FIFA Kupa e Botës U17, si dhe FIFA Kupën e Botës (vajzat).
Edhe në vitin 2023, vazhdoi tradita e transmetimit të FIFA Futbollistit të Vitit, ceremoni që për dekada mbetet në ekranin e RTK-së.
Nga futsalli RTK e transmetoi ekskluzivisht ngjarjen më të madhe të organizuar në Kosovë, UEFA Futsal Champions League, në raundin elitë, që për herë të parë nikoqire ishte Prishtina.

Pjesa e dytë e vitit 2023, veçohet për dy ngjarje të tjera ekskluzive të RTK-së, e të cilat për herë të parë pati rast t'i presë Kosova.



BJA Kampionati Ballkanik i xhudos dhe EJU Kampionati i Hapur Evropian i Xhudos, ishin dy ngjarje, ku krahas aspektit programor, RTK mori nota të larta vlerësimi edhe në aspektin teknik dhe atë televiziv të mbulueshmërisë, sipas kërkesave të Federatës Evropiane të Xhudos (EJU). Sinjali i RTK-së u shpërnda në mbarë botën, duke qenë transmetues nikoqir (Host broadcaster).

Në vitin 2023, nuk mungoi edhe hendbolli, me ndeshjet e kombëtareve (djemtë dhe vajzat), sikurse edhe me derbit e Superligës.
Transmetuesi Publik po ashtu në korrik 2023, solli transmetimin e 12 ndeshjeve nga EHF Kampionati Evropian U19 i vajzave, i organizuar në Prishtinë.
Gjatë vitit 2023, një vëmendje e madhe iu dha edhe sportit paralimpik, në promovimin e sportistëve me aftësi të kufizuara, duke transmetuar drejtpërdrejt ceremoninë e "Lojërave paralimpike".
RTK për dekada është identifikuar edhe në promovimin e ngjarjeve të mëdha të atletikës, si transmetimi i "Maratonës së Prishtinës", apo edhe i turneve prestigjiozë në Kosovë, "Adem Jashari", "Pavarësia" e "Lah Nimani" në boks.

Produksioni

Produksioni i RTK-TV-së ka arritur të realizojë në cilësinë më të lartë televizive të gjitha koncertet e Filarmonisë, Festivalin e parë të këngës në RTK si dhe koncertin e madh të tenorit Rame Lahaj.
Shtimi i programeve të reja ka rritur volumin e punës e si risi mund të veçohen emisionet kulturore "Tinguj dhe fjalë", "RTK Classic" "Rock n'bllok", "Verë n'RTK" Koncerti për Pavarësinë, Defender 2023 etj.
Programi i Mëngjesit në TV ka kaluar një vit të suksesshëm, duke sjellë informacione, argëtim dhe përfshirje të gjitha kategorive shoqërore. Matjet e shikueshmërisë dëshmojnë se Programi i Mëngjesit në RTK është më i shikuari në vend. Gjatë vitit 2023, janë realizuar 363 emisione, ndërsa kanë qenë të ftuar 1 mijë e 309 mysafirë, prej të cilëve 634 të gjinisë femërore dhe 675 të gjinisë mashkullore. Janë realizuar rreth 320 kronika nga terreni, ndërsa ka pasur më shumë se 600 lidhje direkte nga vende të ndryshme brenda dhe jashtë vendit.
Nga data 23 tetor 2023, në skemën programore të RTK 1 është inkuadruar vizualisht edhe programi i mëngjesit i radios nga ora 06:00 deri në orën 07.00, si dhe pas përfundimit të programit televiziv "Mirëmëngjesi Kosovë", nga ora 09:30 emetohet "Metropol" po ashtu nga Radio Kosova.
Në debatin kryesor politik në TV, RTK PRIME, gjatë këtij vitit, kanë qenë të tre liderët institucionalë, liderët opozitarë (duke përjashtuar liderin e LDK-së), udhëheqësit e organeve të sigurisë, ambasadorë të vendeve të ndryshme, politikanë nga rajoni etj.

Seriali "Tosta te Suki"



Në përmbushje të misionit, RTK ka shpallur thirrjen publike për vepra audiovizuele, ku kanë aplikuar shumë projekte. Komisioni profesional i RTK-së e ka përzgjedhur si projektin më të përshtatshëm serialin "Tosta te Suki", i cili është transmetuar në RTK 1 nga data 16 tetor deri më 25 dhjetor. Gjithsej janë transmetuar 11 episode të këtij seriali, i cili ka ngjallur interesim te publiku.

Programi Festiv i Vitit të Ri & Liberalizimi i Vizave

RTK nga muaji tetor 2023 ka filluar përgatitjet programore për netët festive të Vitit të Ri. Me këtë rast është angazhuar kryesisht stafi i brendshëm, por edhe bashkëpunëtorë të jashtëm.
Festa, sivjet ka përkuar edhe me një ngjarje të rëndësishme – liberalizimi i vizave.
Programi i Vitit të Ri ka qenë i realizuar në mënyrë profesionale dhe konform misionit të Transmetuesit Publik. RTK 1 ka hapur programin e vet festiv gjithëditor që nga mëngjesi me "Mirëmëngjesi Kosovë", për të vazhduar me Studion e Hapur për të argëtuar publikun me Festën e Vitit të Ri dhe për të informuar po ashtu me zhvillimet e fundit në lidhje me liberalizimin e vizave.
Programi festiv i vitit te ri për tri ditë radhazi ka ofruar program festiv duke mos lënë anash atë informativ me zhvillime rreth udhëtimeve të para me rastin e liberalizimit të vizave.



Raportin e plotë të punës së RTK1/3/4 mund ta lexoni këtu.



TV RTK 2 në vitin 2023, pavarësisht sfidave të shumta si mungesa e punëtorëve, pajisjeve të vjetra, mungesa e hapësirës adekuate, studiot e vjetra, mungesa e automjeteve për terren, ka arritur të realizojë objektivat e përcaktuara. Kemi përgatitur një program të shumëllojshëm dhe interesant, i përshtatur për të gjitha moshat dhe profesionet. Jemi kujdesur për përfaqësimin e të dy gjinive, si te mysafirët ashtu edhe tek temat që kemi trajtuar. Gazetarët tanë kanë raportuar nga të gjitha ngjarjet e rëndësishme, ndërsa në emisionet informative, shikuesit kanë mundur të dëgjojnë informacione të sakta, objektive dhe në kohë.

fundon me Dnevnik 3, i cili transmetohet në orën 22:00.

Në emisionin "Popodne", i cili transmetohet gjashtë ditë në javë nga ora 17:00, shikuesit mund të marrin informacione të detajuara rreth shumë ngjarjeve të paralajmëruara ose të mbajtura, për kulturën, kuriozitete, histori të jetës dhe temave sociale.

"Nedeljom zajedno": Emision muziko-argëtues gjatë të cilit mundohemi të paraqesim shikuesve tanë, përveç mysafirëve nga bota e kulturës dhe artit, edhe artistë të afirmuar dhe më pak të njohur, si dhe shoqatat kulturo-artistike.

Disa nga emisionet tona më të shikuara ishin:



Çdo mëngjes nga ora 8, në Programin e Mëngjesit ofronim informacione servisore për shikuesit, lajmet e para të mëngjesit, paralajmërojmë ngjarjet e ditës, trajtojmë tema të rëndësishme politike, shoqërore, ekonomike, si dhe kulturore dhe sportive. Shikuesve tanë u jepet mundësia të shohin historitë e jetës nëpërmjet shumë reportazheve dhe gjithashtu sjellim kuriozitete nga e gjithë bota. Në Dnevnik 1, ofrojmë informacione më të hollësishme nga Kosova, rajoni dhe bota.

Lajmet dhe informacionet më të reja, shikuesit tanë, kanë mundësi të shohin në lajmet e shkurtra në orën 12:15. Emisioni qendror informativ, Dnevnik 2, përgatitet me kujdes të veçantë, për të siguruar që shikuesit tanë të jenë të informuar rreth të gjitha ngjarjeve më të rëndësishme. Blloku informativ për-

"Razgovor": Emision në të cilin me mysafirin bashkëbisedohet për temat aktuale, më së shpeshti për temat politike.


"Zdravi bili": Emisioni në të cilin me mysafirë, ekspertë nga fusha e mjekësisë, flasim për parandalimin dhe trajtimin e shumë sëmundjeve.

"Kulturni mozaik": Lajmet më të rëndësishme nga fusha e kulturës. Promovojmë teatrin, kinemanë, muzikën klasike, pikturën, letërsinë. Zbulojmë talente të reja dhe dimensione të reja të artit.

"Koraci": Me imazhe regjistrojmë hapat e parë të talenteve të rinj dhe shpresave të reja, me dëshirën që kur të bëhen suksesshëm një ditë, emisioni ynë të jetë një kujtesë për fillimin, shpresën, dëshirën dhe mundin.

“Roditelj u praksi”: Emisioni nëpërmjet të cilit prindërit e rinj dhe ata me përvojë mund të mësojnë shumë në lidhje me prindërimin, planifikimin e familjes, rritjen e fëmijëve, kujdesin për foshnjat dhe lehonat.

dhe shembullin që ofrojnë shumë gra të reja.
“Deca znaju”: Pyetje të shkurtra për fëmijët e moshës parashkollore dhe ciklit të ulët shkollor mbi shumë koncepte jetësore.



“Selo u venama” Emisioni për bujqësinë dhe njerëzit që jetojnë në fshat. Cilësi të veçanta emisionit i japin këshillat e ekspertëve bujqësorë, të cilët janë pjesëmarrës të domosdoshëm në çdo emision.
“Zapisi sa izvora” – Emisioni dokumentar, kryesisht nga veriu i Kosovës, rreth jetës së përditshme të njerëzve, traditave, kulturës dhe zakoneve, të cilin për nevojat e RTK 2 e realizon Ivan Vučković.



“Majstor i šegrt”: Emisioni për zanatet, për të ardhmen e tyre, rentabilitetin, për artizanët dhe çirakët, për njerëzit e vyeshëm dhe punën që e bëjnë me dashuri.
“Da se žene pitaju”: Emisioni në të cilin zërin dhe mendimet e tyre i japin shumë gra të suksesshme. Flitet për sfidat e tyre, frikat, rrugën e tyre të jetës

RTK2 gjatë vitit 2023 ka transmetuar programe të komuniteteve si dhe lajme në gjuhën shqipe. Po ashtu, është transmetuar edhe programi i produksioneve të jashtme (Zëri i Amerikës, Radio Evropa e Lirë). Kemi përgatitur një program të pasur dhe interesant për festat e Vitit të Ri dhe Krishtlindjeve, me shumë emisione, si në studio, ashtu edhe në terren. Deri në mbylljen e redaksisë së sportit, për shkak të mungesës së gazetarëve sportivë, kemi arritur të ndjekim të gjitha ngjarjet më të rëndësishme sportive.
Gjatë vitit 2023, janë realizuar 11 intervista speciale për ngjarje të rëndësishme dhe për të bërë një bilanc të rezultateve të punës. Kemi realizuar transmetime të drejtpërdrejta, si dhe emisione në lidhje me disa ngjarje speciale.
Edhe gjatë vitit 2023, punonjësit në RTK 2 kanë fituar çmime në festivale të njohura. Me çmime u shpërblyen Dragana Pajović, Žarko Joksimović, Aleksandar Miladinović dhe Ersin Šamlji.

Raportin e detajuar mund ta lexoni këtu.



RADIO KOSOVA

Në vitin 2023 janë bërë ndryshime rrënjësore në Radio Kosovë si në aspektin programor ashtu edhe në atë teknik.
Gjatë vitit 2023 kanë nisur proceduarat për blerjen e dy transmetuesve për pikën qendrore në Golesh dhe sistemit të antenave në Zatriq që mbulon rajonin e Dukagjinit pasi problem mbetet çështja e mbulueshmërisë së territorit të Kosovës me sinjal tokësor si pasojë e mungesës së investimeve në pajisjet transmetuese për 23 vjet.

PROGRAMI

Në vjeshtë ka nisur skema e re programore e konceptuar sipas terminëve kohorë (Mëngjesi, Mesdita, Pasditja, Nata). Skema bazohet kryesisht në blloqe-oraresh me nga dy prezantues / drejtues për secilin termin programor dhe si e tillë ka sjellë frymë dhe dinamikë të re të funksionimit tërësisht të ndryshme prej asaj që është etabluar prej vitesh dhe me një program më aktiv, rritje të prodhimit, shfrytëzim më racional të resurseve njerëzore, stabilitet dhe planifikim më të mirë.
Radio Kosova ka nisur realizimin dhe transmetimin e drejtpërdrejtë të dy emisioneve në TV. Nga e hëna në të premten, nga Radio për RTK1 realizohen dy orë e gjysmë program premierë live; Programi i Mëngjesit dhe emisioni sarkastik "Metropol" të cilët kanë sjellë risi dhe freski në skemën programore.



Në korrik-gusht 2023, janë konceptuar dhe realizuar me sukses skemat verore programore, "Vera me Radio Kosovën" në Radio Kosova 1 përkatësisht "Summer Time" në Radio Kosova 2.
Radio Kosova ka hyrë në skemën e re tërësisht e ribrenduar.
Më 05 qershor, janë lansuar siglat e reja për edicionet e shkurta të lajmeve ndërsa më 03 korrik, siglat e reja për edicionet e gjata të lajmeve për redaksitë: shqipe, serbe, boshnjake, turke dhe rome. Përveç tingujve të rinj, siglat kanë tekst, narracion, strukturë dhe përmbajtje të re të cilat si tërësi kanë sjellë një dinamikë të re në program.

Në natën e ndërrimit të moteve është transmetuar koncerti i Komunës së Prishtinës ku është pasqyruar në kohë reale atmosfera festive në kryeqytet deri në orët e hershme të mëngjesit. Po ashtu është organizuar program special i drejtpërdrejtë gjithëditor me lidhje të drejtpërdrejta nga kryeqyteti dhe komunat ku është pasqyruar atmosferën festive. Me rastin e kësaj feste janë përgatitur materiale, reportazhe dhe dokumentare speciale kushtuar Vitit të Ri
Në vitin 2023 Radio Kosova ka realizuar me sukses dy projekte të veçanta:



Në fund të muajit dhjetor ka organizuar për herë të parë kampanjën humanitare "Bashkë për fëmijët" e cila ka pasur për qëllim që me rastin e festës së Vitit të Ri të mbështetësë dhe gëzojë fëmijët më të cenueshëm të shoqërisë si: fëmijët e abuzuar, fëmijët me asistencë sociale, fëmijët në gjendje rruge dhe fëmijët që trajtohen me kimi-

oterapi në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës. Ky aksion ka arritur të grumbullojë mbi 500 dhurata të cilat janë shpërndarë tek fëmijët në nevojë.
Për të festuar përmbylljen e kampanjës humanitare "Bashkë për fëmijët" më 28 dhjetor, Radio Kosova, ka organizuar në sheshin "Xhorxh Bush" në Prishtinë, Koncertin Festiv të fundvitit ku kanë performuar artistë të ndryshëm të skenës muzikore kosovare.



Vala Mulliqi duke kënduar në koncertin festiv të Radio Kosovës

Ky koncert rreth 4 orësh njëherësh ka përbërë pjesën qendrore të programit festiv për Vitin e Ri më datën 31 dhjetor në Radio Kosova 1 ndërsa është transmetuar si premierë televizive në natën e dytë të vitit të ri në

Projektet e reja zhvillimore
-Në muajin tetor është rinovuar dhe funksionalizuar studio për realizimin e video podcasteve.
-Krahas digjitalizimit të audio-materialeve, gjatë muajit qershor ka filluar nga Njësia e Produksionit edhe digjitalizimi i librave amzë të shiritave magnetikë, në mënyrë që të lehtësohet puna e redaksisë së muzikës në identifikimin dhe përshkrimin e të gjitha materialeve të digjitalizuara.
-Në shtator është zgjidhur problemi 23-vjeçar i mungesës së ventilimit dhe ajrosjes në studiot e Transmetimit dhe të Produksionit në Radio Kosova 1 dhe Radio Kosova 2
-Janë blerë 10 procesorë të zërit dhe katër mikrofonë të teknologjisë së fundit për studiot e On Air-it dhe të Produksionit të cilët e kanë përmirësuar cilësinë e zërit në transmetim (largimin e zhurmës, rregullimin e bass-it dhe fuqizimin e zërit), duke e sjellë Radio Kosovën në një stad të ri të zhvillimit dhe si medie konkurrente në tregun medial.
-Pas ofrimit të dëshmive zyrtare tek TUNEIN, MY-TUNER, është lejuar qasja për editimin dhe plotësimin me informata të dy kanaleve të RTK-Radios përfshirë ndryshimin e emërtimit të gjeolokacionit nga "Kosova e Metohija" në Prishtinë, Kosovë, plotësimin e adresës së saktë, dizajnit, sloganit, frekuencave, përshkrimit të radios si dhe të ndërlidhjes me




faqen zyrtare të uebit të RTK-së dhe linqet e rrjeteve sociale.
-Në muajin maj është plotësuar me informata sistemi i të dhënave për radio (RDS) i cili ka qenë i papërditësuar. Dëgjuesve, të cilët kanë pranues të avancuar (Radio me monitor) në veturat e tyre, tashmë u ofrohen më shumë informata nga ky sistem për Radio Kosova 1 dhe Radio Kosova 2 si: frekuencat, numri kontaktues, e-maili dhe ueb-faqja zyrtare e RTK-së.
-Realizimi i video intervistave – Radio Kosova ka nisur po ashtu edhe realizimin e video-intervistave që krahas transmetimit në radio të publikohen edhe në rrjetet sociale, gjithmonë duke ruajtur imazhin, natyrën dhe specifikat e Radios.
Raportin e plotë të aktiviteteve vjetore mund ta lexoni këtu.



RTK LIVE

Në vitin 2023, Mediet Online ndryshuan rrënjësisht, si në aspektin përmbajtjesor/editorial, ashtu edhe në atë vizuel. Ky vit u karakterizua nga rritja e shifrave dhe përqindjeve, si në postime ashtu edhe në lexueshmëri/shikueshmëri në të gjitha platformat ekzistuese të RTK-së, por edhe me krijimin e faqeve dhe platformave të reja.

Platformat e reja



Në faqen zyrtare të RTK-së, rtklive.com, në vitin 2023 përfundimisht është ndarë stafi në redaktorë dhe gazetarë, për dallim nga periudha e mëhershme kur kishte staf me kontrata dhe përgjegjësi të njëjta (gazetar/redaktor). Më herët, kushdo ka postuar çfarëdo, pa një zinxhir të qartë hierarkie apo llogaridhënie.

Tashmë në ueb-faqen e RTK-së në gjuhën shqipe janë 6 redaktorë dhe 8 gazetarë, dy prej tyre gazetarë të sportit, dhe secili redaktor mban përgjegjësi për ndërrimin e tij/saj. Nga praktika e marrjes së lajmeve copy/paste nga portale të ndryshme vendore e të huaja, kemi vënë në zbatim praktikën e përgatitjes së lajmeve, verifikimit nga ana ynë, si dhe kemi arritur që stafi i uebit të përfshihet në Dhomën e Integruar të Lajmeve, bashkë me televizionin, për të pasur bashkëpunim sa më të mirë dhe funksionim më të lehtë në praktikë.

Mediat Online kanë shtuar numrin e postimeve – si fotolajmeve ashtu edhe videolajmeve – si në Facebook, ashtu edhe në Instagram, në dy platformat më të rëndësishme për RTK-në. Gjithashtu janë krijuar dizajne të përshtatshme për rrjete sociale. Postimet janë bërë me planifikim dhe verifikim, duke u ofruar ndjekësve edhe transmetime të drejtpërdrejta, të ngjarjeve dhe programeve më të rëndësishme. Në këto faqe, përveç lajmeve ditore, mund të gjenden pjesë të shkëputura nga emisionet e RTK-së, në të cilat përfshihen edhe linqet e Youtube, për ata që duan t`i shohin emisionet e plota.

Në Instagram, në vitin 2023 kemi arritur të marrim verifikimin zyrtar, “Blue Tick”, nga Meta Bussines.

Aktualisht, në ish-Twitter, X, postojmë në gjuhën angleze dhe jemi adresë serioze për informim të audiencave të huaja, jashtë Kosovës.



Monetizimi

Në vitin 2023, kemi arritur që Facebook-un dhe Youtube-n e RTK 2 ta monetizojmë. Pavarësisht se nuk janë regjistruar të ardhura të mëdha nga këto dy platforma, është një fillim i mirë dhe ka predispozita që të rriten këto të ardhura, nëse shtohet prodhimi i përshtatshëm për rrjete sociale nga RTK2.

Në të njëjtën kohë, jemi në fazën finale të krijimit të faqes RTK Videos, e cila ka synim postimin e videove të ndryshme, kryesisht nga arkiva e RTK-së, por edhe video autentike të prodhuara nga RTK. Sapo të fillojë funksionimi i faqes, do të vazhdojmë edhe me monetizim, meqë janë plotësuar kushtet teknike që të zbatohet ky plan.

Kliko këtu për më shumë detaje.

Projekte inovative dhe IT

• RTK 2 kalimi në HD – RTK gjatë vitit 2018 ka kaluar nga formati SD në atë HD. Ky ndryshim nuk e kishte përfshirë RTK 2, kanal ky i cili ka vazhduar transmetimin në formatin SD format që është tejkaluar në aspektin teknologjik. Departamenti i TI-së ka krijuar ekip i cili ka ofruar zgjidhje teknike për avancimin e transmetimit të kanalit RTK 2 nga formati SD në atë HD (ky ndryshim është bërë me resurse të brendshme njerëzore dhe teknike pa implikime financiare).

• Digjitalizimi nga kasetat SX - RTK në periudhën 1999-2014 si medium të prodhimit/transmetimit/ arkivimit ka përdorur kasetën BETACAM SX/SP dhe si rrjedhojë ka 29.000 njësi të këtyre kasetave të cilat përmbajnë arkivin e RTK-së për këtë periudhë.

Në këto kaseta ka përmbajtje të rëndësisë së veçantë në aspektin historik, kulturor e artistik.

RTK ka marrë donacion nga JICA në vitin 1999 20 njësi të Betacam VTR Player, disa prej tyre kanë qenë funksionale, disa i kemi riparuar për të filluar



digjitalizimin me prioritet pasi blerja e këtyre pajisjeve është e vështirë dhe e kushtueshme. Duke marrë parasysh faktin që këto pajisje nuk prodhohen më, ky ka qenë momenti i fundit që kjo përmbajtje arkivore të digjitalizohet me resurse të brendshme teknike dhe njerëzore, pasi digjitalizimi si shërbim është shumë i kushtueshëm.

• Digjitalizimi i audio shiritave të RTP-së - Krijimi i infrastrukturës së nevojshme për digjitalizimin e audio shiritave të Radio Prishtinës, definimi i standardit për digjitalizim dhe metadata, krijimi i ndërlidhjeve të nevojshme për postproduksion nga redaksia e muzikës, ruajtja e këtij materiali në dy kopje të ndryshme (ky proces është bërë me resurse të brendshme njerëzore dhe teknike, pa implikime financiare).



• Integrimi i Radio Kosovës në Rrjete dhe sisteme-Radio Kosova që nga themelimi ka operuar me resurse dhe sisteme teknike të ndara nga TV. Kjo, përveçqë ka krijuar kosto shtesë për RTK-në ka krijuar dhe vështirësi në bashkëpunim të mirëfilltë të dhomave të lajmeve në TV dhe Radio.
Gjatë vitit 2023, Departamenti i TI-së ka krijuar një lidhje të veçantë TV-Radio, në mënyrë që stafi i dhomës së lajmeve në Radio të ketë qasje në sistemin e prodhimit duke mundësuar shkëmbimin e informatave në kohë reale.



• Moduli për distribucionin e brendshëm të RTK 1, 2, 3, 4 dhe RK 1, 2 –
Departamenti i TI-së ka eliminuar nevojën për blerjen e shërbimit të operatorëve kabllorë për distribucionin e kanaleve të RTK-së në dhomat e lajmeve, zyra apo hapësira të përbashkëta duke përdorur vegla softuerike dhe protokolle open source siç janë (FFMPG, NDI, RTP) vegla të cilat janë vendosur në pajisje siç janë PC, Raspberry PI 2.

• Regjia televizive në Radio Kosova-

Trendët e zhvillimit të medias jolineare (rrjete sociale, platforma online) kanë bërë që Radio të transformohet nga një medium që transmeton ekskluz-



ivisht ne audio në një medium audio-viziv.
Duke e pasur parasysh që nuk kanë ekzistuar mundësitë financiare për blerjen e pajisjeve televizive në radio departamenti i TI-së ka krijuar një ambient teknologjik që është i bazuar tërësisht në vegla softuerike siç janë NDI, FFMPEG, Vmix. Këto vegla kanë mundësuar që Radio Kosova të ndjekë trendin global për krijimin e përmbajtjes audio-vizive.
Departamenti i TI-së, përveç krijimit të sistemit për



prodhim audioviziv, ka ofruar trajnim për të gjithë stafin teknik për operim me këtë sistem.

• Njësi për Post-Produksion dhe Upscale përmes Inteligjencës Artificiale - Krijimi i njësisë së Post Produksionit (Harduer dhe Softuer) me kapacitet për të bërë konvertimin e materialeve nga Standard Definition (SD) në formatin e avancuar High Definition (HD) pa humbje, duke përdorur model të inteligjencës artificiale për kryerjen e këtij procesi. Po ashtu, kjo njësi është e pajisur dhe me veglën softuerike Davinci Resolve që mundëson kor-



• Lidhja TV-Radio në kohë reale me talkback - Krijimi i lidhjes TV-Radio që mundëson transmetimin e video dhe audio sinjalit pa asnjë humbje dhe në kohë reale (Lossles and Realtime), duke përdorur protokollin më të ri për transmetimin e video/audio sinjaleve që quhet NDI dhe është vegël pa pagesë. Po ashtu duke përdorur vegla softuerike është mundësuar Talkback në kohë reale në mes dy studiove TV -Radio (Ky zhvillim është bërë me resurse të brendshme njerëzore dhe teknike).



`• A.I Upscale - Departamenti i TI-së, gjatë vitit 2023, ka arritur të konvertojë 2 sezone të serialit “Familja Moderne” në formatin HD pavarësisht se ky serial është prodhuar tërësisht në pajisje të limituara ne formatin SD. Ky zhvillim nuk ka qenë i mundur pa zhvillimet e fundit në teknologjinë e inteligjencës artificiale.



•IP Based Master Control Room (MCR) – Njësi që bën transmetimin/distribucionin e RTK 1, 2, 3, 4. Kjo njësi, përveç transmetimit të të gjithë programeve të RTK-së sipas skemës programore, bën edhe distribucionin e të gjitha kanaleve tek operatorët kabllorë dhe online. RTK ka një koncept modern të MCR pasi nuk përdor pajisje klasike televizive siç janë video mikser, audio mikser, njësi grafike etj. Të gjitha këto funksione i kryen pjesa softuerike përmes serverëve. Pjesa harduerike është blerë në vitin 2018 dhe nuk ka pasur nevojë për intervenime gjatë vitit, për t`u siguruar në mbarëvajtjen e transmetimit të programeve të RTK-së. Raporti i plotë



FINANCAT

Raporti reflekton aktivitetet e kryera - përmbushjen e punës për vitin 2023 të Shërbimit Financiar për periudhën, 1 janar-31dhjetor 2023, matjen e saj dhe krahasimin me detyrimet e planifikuara dhe objektivat e caktuara.

Bilanci fillestar i pashpenzuar nga viti paraprak ishte në shumë prej €60,468. Të hyrat e realizuara për këtë periudhë raportuese janë në shume prej €10,205,319. Shpenzimet e paguara janë në shumë prej €9,993,927 dhe bilanci përfundimtar i pashpenzuar është në shumë prej €331,860.

a) Të hyrat

RTK për këtë periudhë ka realizuar gjithsej €10,205,319, prej të cilave të hyrat nga buxheti i Kosovës €8,960,000 shprehur në përqindje 87,80%, të hyrat nga marketingu €650,111 apo shprehur në përqindje 6.37%, të hyrat e tjera €295,208 apo shprehur në përqindje 2.89% dhe të hyrat nga MKRS për Festivalin e Këngës në RTK 300,000 apo shprehur në përqindje 2.94%

Gjatë vitit 2023 janë inkasuar borxhe të vjetra në shumë prej €256,147 dhe atë €236,188 nga marketingu dhe €19,959 nga të hyrat për vendosjen e antenave të Telekomit të Kosovës.

Në kategorinë të hyrat përfshihen: Të hyrat nga buxheti i Kosovës, të hyrat nga marketingu dhe të hyrat vetanake te cilat janë: të hyrat nga Youtube, antenat, KFOR-i, materiali arkivor dhe të tjera si dhe hyrat nga MKRS për Festivalin e Këngës në RTK.

- Të hyrat nga buxheti i Kosovës paguhen në bazë të Ligjit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2023, nr. 08/L-193, Neni 11, paragrafi 12 dhe pagesa transferohet para secilit 3-mujor.
- Të hyrat nga marketingu të vitit 2023 janë më të larta se të hyrat e vitit 2022 për arsye të gjatë vitit 2023 janë arkëtuar llogaritë e arkëtueshme nga marketingu i vitit 2022 që kanë të bëjnë me Kampionatin Botëror të Futbollit "Qatar 2022".
- Të hyrat vetanake të vitit 2023 janë më të larta se të hyrat e vitit 2022, sepse gjatë vitit 2023 kemi inkasuar borxhin e vjetër për të hyrat nga antenat.
- Ndryshimi i të hyrave nga MKRS për Festivalin e Këngës në RTK është për arsye se është viti i parë i transmetimit të Festivalit në fjalë.

b) Shpenzimet

RTK në periudhën raportuese ka shpenzuar €9,933,927, prej të cilave në kategorinë Paga €8,014,161, në kategorinë Investimet Kapitale €231,546, shpenzime komunale €166,152 Mallra dhe shërbime €1,184,498 dhe Festivali i Këngës në RTK €337,570.

Përqindja e realizimit të buxhetit sipas kategorive të veçanta buxhetore është si vijon: Paga 80,67%, Investimet Kapitale 2.34%, Shpenzime komunale 1.67% Mallra dhe shërbimet 11,92% dhe Festivali i Këngës në RTK 3.40%. Pasqyrat financiare mund të lexohen këtu.

Raporti Financiar sipas kategorive kryesore për vitin 2021-2023

Përshkrimi	Viti 2021 1	Viti 2022 2	Viti 2023 3	Ndryshimi (3-1)
Bilanci fillestar	50,231	41,916	60,468	18,552
Të hyrat nga Buxheti i Kosovës	11,200,000	8,960,000	8,960,000	(2,240,000)
Të hyrat nga marketingu në të gatshme	602,193	505,112	650,111	47,918
Të hyrat e tjera nga Youtube, antena, kthimi i obligimeve financiare nga Qeveria		280,211	295,208	295,208
Të hyra nga MKRS për Festivalin e Këngës së RTK - së	252,245	0	300,000	47,755
Nën total	12,054,438	9,745,323	10,205,319	(1,849,119)
Pagat	9,769,878	8,282,959	8,131,790	(1,638,087)
Investimet kapitale	386,012	90,533	231,546	(154,466)
Komunalit	255,766	242,687	166,152	(89,614)
Mallëra dhe Sherbime	1,651,098	1,110,592	1,066,869	(584,229)
Festivali i Këngës në RTK			337,570	337,570
Nën total	12,062,753	9,726,771	9,933,927	(2,128,826)
Bilanci përfundimtar	41,916	60,468	331,860	279,707
Përshkrimi	Viti 2021 1	Viti 2022 2	Viti 2023 3	Ndryshimi (3-2)
Llogaritë e pagueshme	2,009,917	1,702,715	1,006,261	(1,003,655)
Llogaritë e arkëtueshme	414,536	532,133	230,773	(183,763)
Detyrimet Kontingjente			373,742	373,742

Departamenti i Marketingut ka arritur objekivat për vitin 2023 duke inkasuar 650,111 Euro. Raporti i plotë mund të lexohet këtu.

Stafi - Burimet njerëzore


Gjatë vitit 2023 ka vazhduar trendi i reduktimit të stafit. Në fund të vitit 2023, numri i punëtorëve të rregullt aktivë ka qenë 722, duke mos përfshirë 22 persona që janë në pushim pa pagesë.

DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS DHE BURIMEVE NJËRËZORE

DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS DHE BURIMEVE NJËRËZORE


Raport për numrin e të punësuarve me kontratë të rregullt

Departamenti	Nr. aktual i punëtorëve në fund të dhjetorit 2023	Nr. aktual i punëtorëve në fund të dhjetorit 2022	Nr. aktual i punëtorëve në fund të dhjetorit 2021
RTK TV (1, 3, 4)	490	502	506
RTK 2 TV	74	76	56
RTK Radio (1, 2)	132	136	147
Shërbimet e përbashkëta	48	53	55
Gjithsej	744	767	764




Raport për numrin e të punësuarve me kontratë për shërbime – bashkëpunëtorët e jashtëm

Departamenti	Nr. aktual i bashkëpunëtorëve në fund të dhjetorit 2023	Nr. aktual i bashkëpunëtorëve në fund të dhjetorit 2022	Nr. aktual i bashkëpunëtorëve në fund të dhjetorit 2021
RTK TV (1; 3; 4)	12	12	137
RTK 2 TV	0	0	38
RTK Radio (1; 2)	0	0	34
Të tjera	0	0	49
Gjithsej	12	12	258




REKRUTIMET

Rekrutimet 2021	Rekrutimet 2022	Rekrutimet 2023
0 të punësuar të rinj	45 të punësuar të rinj	16 të punësuar të rinj



SHKËPUTJET E KONTRATAVE

Shkëputje të kontratave 2021	Shkëputje të kontratave 2022	Shkëputje të kontratave 2023
10 ndërprerje të kontratave	13 ndërprerje të kontratave	27 ndërprerje të kontratave
15 pensionime	13 pensionime	16 pensionime
25 të punësuar	26 të punësuar	43 të punësuar



ZYRA LIGJORE
NDRYSHIMET NË LEGJISLACIONIN SEKONDAR

Raporti i mëposhtëm ofron një pasqyrë të detyrimeve kontingjente. Përfshihen rastet civile, komerciale dhe administrative, duke përfshirë çështjet më të reja dhe të rëndësishme të paraqitura për zhvillimin e proceseve gjyqësore. Raporti përmban informacione të detajuara për secilin rast, përfshirë emrat e palëve, çështjen juridike, faktet kyçe të rastit dhe vendimet e marra nga gjykatat përkatëse. Janë gjithsej tridhjetë e një (31) raste aktive në departamentin civil, shtatëmbëdhjetë (17) raste në Gjykatën Komerciale, katër (4) raste në Gjykatën Supreme dhe një në Gjykatën Kushtetuese. Kanë përfunduar me proces të rregullt gjyqësor gjithsej tridhjetë e dy (32) raste. Prej tyre njëzet e dy (22) kanë përfunduar në favor të RTK-së, që kapin vlerën e përafërt prej dyqind mijë euro (200,000.00) €.
Tabela e çështjeve gjyqësore ku gjatë vitit 2023 kemi ndjekur dhe ndërmarrë veprimet e nevojshme juridike

Ndryshimet në fushën legjislative:
Gjatë vitit 2022-2023 është bërë amendamentimi i Rregullores për Marketing dhe Rregullores për punën e Bordit, miratimi i Rregullores së Festivalit të Këngës në Radiotelevizionin e Kosovës; Rregullores për Angazhimin e Ekspertëve Bashkëpunëtorëve të Jashtëm dhe Audicionin për Festivalin e Këngës në RTK; Rregullores për parandalimin e konfliktit të interesit në RTK; Statutit për Funksionimin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm, dhe Statuti i Komitetit të Auditimit në RTK. Është shfuqizuar Rregullorja për udhëtime zyrtare në RTK.
Në proces të amendamentimit është Rregullorja për procedurat e përzgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm dhe Menaxhmentit të lartë të RTK-së, si dhe Rregullorja për procedurat dhe kriteret në përzgjedhjen e përmbajtjeve audiovizuale të producentëve të pavarur. Pjesa tjetër e rregullativës të brendshme do të amendamentohet gjatë reformës.
Amendamentimi i Ligjit për RTK-në duhet të konsiderohet prioritet gjatë vitit vijues, në mënyrë që të rritet pavarësia dhe integriteti i Radiotelevizionit të Kosovës, të garantojë transparencë dhe të promovojë standardet më të larta profesionale në fushën e medias. Përfshirja e gjerë e akterëve në këtë proces, është e rëndësishme për të siguruar që ndryshimet e propozuara të reflektojnë nevojat dhe sfidat aktuale të transmetuesit publik.
Janë përgatitur dhe dorëzuar dy raporte në Kuvend: Raporti për zgjidhjen e çështjes së pronës dhe Raporti për propozimet lidhur me parapagim. Raporti i plotë mund të lexohet këtu.

Marrëdhëniet ndërkombëtare

Përgjatë vitit 2023 është arritur rrjetëzimi me shumë mekanizma vendor e ndërkombëtar, duke realizuar disa projekteve mjaft të rëndësishme, të cilat kanë kontribuar drejtpërdrejt sikurse në shtimin e vëllimit dhe cilësisë programore, në trajnimin e stafit, ashtu edhe në pajisjen me inventar dhe mjete teknike për të punësuarit në RTK.

teknike për RTK-në, Memorandum bashkëpunimi me ERNO për realizimin e një projekti për mediet online dhe rrjetet sociale, Memorandum Bashkëpunimi me Agjencinë e Lajmeve të Emirateve të Bashkuara Arabe etj. Lexo këtu raportin e plote



Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit RTK-RTSH-RTCG në Shkodër

Ndër Marrëveshjet më të rëndësishme gjatë vitit 2023 janë: Memorandumi i Bashkëpunimit me Institutin Italian të Kulturës në Tiranë, nga i cili RTK përfitoi përmbajtje programore në vlerë prej 80 mijë eurosh, Memorandumi me Radiotelevizionin e Shqipërisë, përmes së cilit vetëm përgjatë 4 muajve të fundit të 2023-ës RTK ka marrë nga RTSH mbi 220 prodhime programore, përkatësisht mbi 145 kronika televizive dhe 75 dokumentarë. Memorandumi i Bashkëpunimit me Malin e Zi, nga i cili RTK siguroj ë mbështetje teknike për realizimin e Festivalit të Këngës pa kosto financiare për shfrytëzimin e pajisjeve teknike,



Memorandumin e përbashkët RTK-RTSH-RTVCG, përmes së cilit do të realizohet një emision i përbashkët rajonal, Nënshkrimin e Kontratës me Institutin Goethe dhe Deutsche Welle, nga e cila përgjatë vitit 2024 do të ketë trajnime të stafit dhe ndihmë

Departamenti për Strategji dhe Zhvillim

Departamenti për Strategji dhe Zhvillim ka pasur një dinamikë të re të angazhimit, qysh në fillim të vitit 2023, menjëherë pas përfundimit të analizës dhe përgatitjes së projeksionit buxhetor të RTK-së për vitin 2023.

Gjatë muajit janar të 2023-s janë zhvilluar edhe disa takime të fundit konsultative për draftimin final të Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet RTK-së dhe MKRS-së, përmes të cilit do të mbështetej themelimi i Festivalit të Këngës në RTK, si dhe bashkëpunime të tjera në fushën e kulturës, sportit dhe rinisë.

Anëtarët e Departamentit për Strategji dhe Zhvillim për më se 7 javë, janë ngarkuar me përgjegjësinë e skanimit të gjendjes aktuale të funksionimit të strukturës organizative të RTK-së. Ky proces ishte i domosdoshëm për të vënë bazat e reformës dhe për të prodhuar një dokument që shërben si pasqyrë/udhëzues për procesin e transformimit të mediumit të vetëm publik në Kosovë.

Ky Departament ka nxjerrë raporte me opinionet ligjore përkitazi me nevojën për ndryshime në rregullativën ligjore të RTK-së. Ne mbledhjet e Menaxhmentit, janë dorëzuar disa rekomandime e opinione ligjore, për amendamentim ose ndryshim të disa prej rregulloreve ekzistuese, të cilat është vlerësuar se bien ndesh me ligjet ekzistuese dhe rregullativën e përgjithshme ligjore të RTK-së. Anëtarët e Departamentit kanë qenë pjesë e vazhdueshme e thuajse të gjitha grupeve punuese për draftim të rregulloreve të RTK-së.

Departamenti ka nxjerrë edhe disa raporte rekomanduese e strategji për uljen e shpenzimeve nëpër disa procese teknologjike të punës dhe rekomandime të detajuara për zhvillime inovative. Janë realizuar hulumtimet e kërkuara, duke sjellë edhe oferta të disa kompanive për përmirësimin e cilësisë së sinjaleve live, të cilat janë shqyrtuar në mbledhjen e Menaxhmentit.

Gjatë muajit mars 2023, bazuar në strategjinë zhvillimore të drejtorit të përgjithshëm të RTK-së dhe në konsultim me të dhe Menaxhmentin e RTK-së, është iniciuar procesi i përpilimit të Strategjisë (afatmesme) Zhvillimore të RTK-së 2024-2027, i cili është finalizuar dhe dorëzuar në Menaxhmentin e RTK-së, gjatë muajit qershor 2023.

Gjatë muajit tetor në Menaxhmentin e RTK-së, është dorëzuar edhe projekt-strategjia RTK Non-linear, për hapjen e një kanali të ri alternativ të medias publike, i cili do t'i dedikohej "gjeneratës Z".

Përfundim

Nga ky raport mund të konkludohet se është realizuar mbi 97% e planit të punës për vitin 2023.

Fakti që RTK renditet në krye të kanaleve më të shikuara dhe të besuara, na motivon që të kërkojmë alternativa për financim të projekteve dhe për të rritur efektivitetin në racionalizimin e stafit.

Duke marrë parasysh se tashmë në Kuvend janë dorëzuar raportet për pronën dhe modelet e financimit është koha e fundit që themeluesi të përcaktojë si çështje prioritare për trajtim këto dy çështje ekzistenciale për Transmetuesin Publik.

Vlen të theksohet se edhe mos amandamentimi i ligjit për RTK-në ka pamundësuar planet për dhomë të integruar të lajmeve, në nivel të të gjitha njësive.

Sfidë mbetet edhe adresimi ligjor i konfliktit të interesit, proces ky që ka nisur të verifikohet në gjysmën e dytë të vitit 2023.

Në këtë kontekst, transmetuesi publik i Kosovës ka nevojë për qëndrueshmëri dhe pavarësi financiare që të vazhdoj projektet madhore, e që pos reformës strukturore e organizative, të ketë të mundur realizimin e ideve të reja programore dhe qasjen adekuate ndaj gjeneratave të reja.